



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
28.06.2024

Me datë 28.06.2024, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Joniz Osmanagaj, Irma Kopliku, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Suada Kopshti, Erkan Hoxha, Marina Duhani, Gloria Shllaku, Fatmir Vojvoda, Imeldi Sokoli, Plarent Anamali, Amina Lici.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Maj 2024"*.
2. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e listës shtesë të përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti"*.
3. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Shkodër"*.
4. Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55 datë,29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.*
5. Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55 datë,29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.*
6. Pr/ Vendim: *"Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndoturave"*.
7. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Z.Luli citon rendin e ditës, duke sqaruar që pika 5. është një shtesë dhe ndryshim i VKB nr.55 datë 29.12.23, për të cilën Këshilli Bashkiak ka marr Vendimin nr.9 në mbledhjen e datës 31.01.24, prandaj nuk ka nevojë për vendim marrje sërish. Gjithashtu ai shprehet se ka një pikë shtesë, pr/vendim: *"Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet fondacionit Shoqëria e hapur për Shqipërinë dhe Bashkisë Shkodër për zbatimin e projektit "Sunny School", i cili ka për qëllim instalimin e impianteve fotovoltaike 9 prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) në shkollat e mesme "Jordan Misja", "Oso Kuka", "Nikollë Zagorjani" dhe shkollat 9-vjeçare "Dëshmorët e Prishtinës", "Edith Durham", "Tringë Smajli" Grudë, "Dëshmorët Rrencit".*

Z.I.Sokoli merr fjalën dhe shprehet me rastin e sulmit ndaj një punonjësi të Bashkisë dhe shton që kjo ngjarje është anashkaluar si nga Bashkia Shkodër ashtu edhe nga Policia e Shtetit. Ai shprehet se kjo duhet të sqarohet, pasi ka shumë rëndësi për opinionin publik.

Z.Luli sqaron se kjo është një pjesë që nuk i takon Këshillit Bashkiak, prandaj duhet të përqëndrohem tek rendi i ditës.

Z.Osmanagaj për procedurë thotë se ka dy kërkesa: 1. Heqjen nga rendi i ditës pikën 6. pasi nuk kemi as pr/vendim as relacion për të. 2. Për pr/vendim shtesë, ai shprehet se nuk ka patur kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e tij.

Përsëri **Z.Luli** sqaron në lidhje me pikën 6 se nga ana e Bashkisë nuk mund të ketë pr/vendim pasi materiali nuk është përgatitur nga administrata e saj, por është përcjellë nga UKSH-ja për dhënie mendimi. Sot kërkohet vetëm të merret vendim nga ana juaj si këshilltar nëse jeni apo jo dakort me tarifat e propozuara.

Znj.Shkrela shprehet se pr/vendimet e ardhura me vonesë po kthehen në precedent, prandaj kërkon të respektohen afatet.

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë **21** vota Pro **9** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Maj 2024".*

Siç është rënë dakort mbledhjen e fundit, kryetarët e grupeve, mendojnë se ky pr/akt nuk ka nevojë për relativim pasi është i përmuajshëm. Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **33** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet e pikën e rradhës të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e listës shtesë të përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti".*

Relaton për këtë pr/vendim **Znj.Kruja**, drejtoreshë, drejtorja e Shërbimit Social dhe Strehimit në Bashkinë Shkodër , sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Sokoli në emër të komisionit shprehet se çmimet aktuale të tregut bëjnë të pamundur përfitimin nga kjo mundësi që jep shteti, prandaj ai propozon që në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, të rishihet kjo pjesë.

Znj.Mehmetaj kërkon gjithashtu të dijë për personat që janë skualifikuar për çështje dokumentacioni a kemi të bëjmë me neglizhencë nga ana e tyre apo mungesë informacioni?

Përgjigjet **Znj.Kruja** duke thënë se specialistët tanë janë gjithmonë të gatshëm të ndihmojnë, në raste të tjera ka tejkalim afatesh ligjore.

Znj.Shkrela sjell shqetësimin e saj lidhur me një familje në nevojë, që jeton në kushte të mjerueshme, të cilës i është siguruar një strehim i përkohshëm. Ajo thotë që për to duhet gjetur një zgjidhje e përhershme pasi janë në gjendje shumë të keqe ekonomike dhe me dy fëmijë të sëmurë.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Z.Osmanagaj për grupin BF dhe Z.I.Sokoli për grupin PD janë dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 33 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën e radhës: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Shkodër"*.

Relaton për pr/vendimin në fjalë **Znj.Haxhi**, drejtoreshë, drejtorja e Buxhetit sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Merr fjalën **Znj.Bajraktari**, e cila kërkon të dijë më tepër në lidhje me të ardhurat nga produktet e veta, taksa mbi tokat bujqësore si dhe për taksat e tjera vendore, ku vërehet një rritje e konsiderueshme në krahasim me vitin 2023. Ajo shton: A përkthehet kjo rritje me rritje taksash për qytetarët?

Përgjigjet **Znj.Teuta Haxhi** duke thënë se materiali në fjalë është diskutuar në mbledhjen e kaluar dhe se rritjet në fjalë nenkuptojnë që Bashkia Shkodër është mobilizuar më së miri për të mbledhur taksat e veta dhe nuk do ketë rritje të taksave dhe tarifave.

Z.Pashuku shprehet se meqënëse taksa e ujitjes ka të bëjë me njësite administrative, ai sugjeron që prezent të jenë edhe administratorët e njësive përkatëse, që secili të paraqesi problematikat e zonës që administron. Ai kërkon të dijë gjithashtu si do bëhet vjelja e kësaj takse?

Z.Mema përgjigjet se vjelja e kësaj takse do bëhet në bazë të aplikimit të fermerëve në varësi të ha tokë që do ujin dhe evidentimit në terren të administratorëve të Njësive administrative.

Z.I.Sokoli kërkon të dijë më tepër në lidhje me shpenzimet e personelit. Cfarë është parashikuar në parim në vazhdimësi?

Përgjigjet **Znj.Haxhi** duke thënë se kjo është vetëm faza e parë e PBA-së dhe në përfundim të projektit do shihen edhe diferencat dhe arsyet pse ka rënie të këtyre shpenzimeve.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit edhe Znj.Shllaku për grupin PD është pro, kurse për grupin BF Z. Osmanagaj shprehet kundër.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **26** vota Pro, **8** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 4. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55 datë,29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar.*

Relaton për pr/vendimin në fjalë **Z.Bekim Mema**, drejtor, drejtorja e përgjithshme e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Pashuku kërkon të dijë pas realizimit të këtyre projekteve në bashkëpunim me ministrinë, a janë parshikuar edhe kostot e mirmbajtjes së këtyre kanaleve vaditëse?

Përgjigjet **Zv/Kryetari Z.Bejleri** duke thënë se në çdo projekt parashikohet realizimi dhe mirëmbajtja.

Znj.Mehmetaj merr fjalën dhe pyet:Kur themi se është parashikuar një fond për mbikqyrjen, a mendohet të ngrihet grup pune apo shtab i veçantë për këtë?

Z.Bejleri sqaron se me këtë fond, Bashkia do kontraktojë një firmë mbikqyrëse që bashkë me kompanitë supervizore dhe stafin e Bashkisë Shkodër projekti të bëhet më së miri.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Z.Osmanagaj për grupin BF dhe Z.I.Sokoli për grupin PD janë dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **33** vota Pro, **1** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 5. të rendit të ditës, (Pika shtesë): Pr/vendim: *“Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet fondacionit Shoqëria e hapur për Shqipërinë dhe Bashkisë Shkodër për zbatimin e projektit “Sunny School”, i cili ka për qëllim instalimin e impianteve fotovoltaike 9 prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) në shkollat e mesme “Jordan Misja”, “Oso Kuka”, “Nikollë Zagorjani” dhe shkollat 9-vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”, “Edith Durham”, “Tringë Smajli” Grudë, “Dëshmorët Rrencit”.*

Relaton për pr/vendimin në fjalë **Znj.Aida Shllaku**, drejtoreshë, drejtorja e Mjedisit sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Znj.Duhani**, e cila shprehet se vëren se kriteri bazë për përzgjedhjen e shkollave përfituese është nr. i nxënësve. Ajo kërkon të njihet nga komisioni përzgjedhës se si ka qënë rënditja e shkollave tjera.

Z.Bejleri sqaron se përveç kriterit të numrit të nxënësve, duhet që shkolla të plotësojë kriteret teknike për të qënë përfituese. Pasi edhe Gjimnazi 28 Nëntori ka nr. të madh nxënësish por çatia e saj nuk plotëson kushtet teknike për vendosjen e paneleve.

Z.Pashuku shprehet se shkollat e njësisë administrative Bërdicë nuk janë asnjëra përfituese edhe pse i plotësojnë të dy kushtet e sipër përmendura. Pse nuk janë përfshirë ato në projekt?

Përgjigjet **Znj.Shllaku** duke thënë se është patur parasysh edhe afërsia me rrjetin më të afërt elektrik. Vlen të theksohet fakti që ky investim do mbulojë krejtësisht nevojën e këtyre shkollave për energji elektrike.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Z.I.Sokoli për grupin PD është dakort, kurse Z.Osmanagaj për grupin BF shprehet kundër.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **33** vota Pro, **1** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Kalohet tek pika e fundit: Pr/ Vendim: *“Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndoturave”.*

Relaton për këtë pikë drejtoresha tregtare e UKSH sh.a Shkodër **Znj.Edona Kraja** dhe drejtori teknik **Z.Lazër Pema** sipas materialit të përgatitur.

Fjalën e merr **Z.Gj.Sokoli** i cili shprehet se problemi i vjetërsisë së pompave të ujit etj.nuk është i ri, prandaj nuk mendon që të ketë rritje tarifash, tani që qytetarët kanë shqetësime të tjera dhe është e papërbalueshme të paguajnë rregullime e mirëmbajtje pompash e sisteme uji. Në emër të grupit të PSD, ai shprehet kundër rritjes së tarifave.

Znj.Gjekaj merr fjalën dhe shprehet se me keqardhje propozimi i paraqitur nuk ka lidhje shkakësore me shërbimin e ofruar, pasi tarifa e pretenduar nuk përkon aspak me shërbimin që UKSH ofron për qytetarët e Shkodrës. Ajo shton se ndërkohë që kërkohet rritje tarifimi nuk ka asnjë përpjekje për përmirsim shërbimi, madje vijohet me pagesa afrofe dhe pse jo edhe me lavazhe që nuk paguajnë për aq sa konsumojnë dhe të mos flasim për humbjet administrative. Edhe **Znj.Gjekaj** shprehet kundër tarifimit të ri të propozuar.

Z.Anamali shprehet se është njohur me relacionin e paraqitur nga UKSH dhe mendon se ka mangësi. Pas një analize të bërë edhe ai shprehet kundër kësaj rritje tarife.

Edhe **Znj.Mehmetaj** shprehet kundër rritjes së tarifave duke theksuar faktin që shërbimi nuk është në porporcion të drejtë me tarifimin e pretenduar. Pasi në relacionin e paraqitur nuk

vëren asnjë parashikim për përmirësim shërbimi. Rritja e tarifës nuk mund të justifikohet vetëm me shërbimet operative dhe rritje të pagës minimale.

Z.Pema shprehet se ndërhyrjet që parashikojnë të bëjnë janë investim që paraprijnë shërbim më të mirë.

Ndërhyn **Znj.Shkrela**, e cila thotë se të tilla investime duhen bërë nga ministria dhe jo nga xhepat e qytetarëve.

Znj.Kopliku merr fjalën dhe citon në mënyrë të detajuar rritjen e kërkuar të tarifave dhe ashtu si kolegët mendon që rritja e tyre është krejtësisht e papranueshme.

Edhe **Z.Doçi** mbështet mendimin e Znj.Kopliku.

Fjalën e merr **Z.I.Sokoli**, i cili gjithashtu shpreh pakënaqësinë e tij dhe padakortësi për relacionin dhe tarifimin e ri. Ai shton se qeveria i detyrohet shumë qytetarëve të Shkodrës dhe UKSH nuk ka pse të kërkojë që ndërhyrjet në rrjet t'i bëjë me taksat e qytetarëve.

Znj.Shkrela shprehet se duke patur parasysh situatën ekonomike të qytetarëve të Shkodrës mendon se është guxim i madh të pretendohet për rritje takse me justifikimin e investimeve dhe ndërhyrjeve në rrjetin e ujësjellësit. Edhe ajo është totalisht kundër rritjes së taksës.

Edhe **Znj.Shllaku** mbështet mendimin e kolegëve dhe shpreh padakortësi.

Po ashtu edhe **Z.Ndou** shpreh shqetësimin e tij në lidhje me taksat duke thënë se kjo për qytetarët është kosto shumë e lartë për mundësitë e tyre ekonomike.

Ky Pr/vendim hidhet në votim, ku rezultojnë 0 vota Pro, **31** Kundër, **0** Abstenim.

Nuk Miratohet

Vijohet me diskutime jashtë rendit të ditës.

Znj.Pode sjell në vëmendje dhe shpreh shqetësimin e saj në lidhje me djegien e tregut në Qafë-Hardhi. Ajo kërkon të gjendet një zgjidhje dhe të mbështeten familjet dhe tregtarët aty. Tjetër shqetësim i saj janë pistonat që bllokojnë hyrjen e automjeteve në rrugën "13 Dhjetori" edhe pas orarit të kufizimit. Ajo shton edhe shqetësimin në lidhje me mbetjet që lënë pas punimet në fasadat e pallateve. Prandaj duhen të merren masa.

Znj.Duhani merr fjalën dhe kërkon të dijë se çfarë masash janë menduar të merren për trafikun e rënduar në hyrje të qytetit?

Edhe **Z.Behri** shpreh shqetësimin e tij në lidhje me sheshin në qendër të Velipojës, duke thënë se lojrat dhe shitësit ambulantë aty prishin imazhin dhe sipas mendimit të tij duhet të gjendet një sistemim më i përshtatshëm për to.

Z. I.Sokoli merr fjalën përsëri dhe mendon që sektori i emergjencave civile ka numër të vogël punonjësish po ashtu edhe zjarrëfikësash pasi u vu re në djegien e tregut që pavarësisht mobilizimit dhe punës së mirë, duhet të kishte më shumë forcë punëtore dhe mjete të specializuara.

Z.Anamali sjell një shqetësim të banorëve të Rr.Myzafer Pipa në lidhje me trafikun. Ato kërkojnë minimalisht që rruga të kthehet me një sens lëvizjeje. Tjetër shqetësim janë vendparkimet e dedikuara. Vërehet që i jepen me shumë se një vendparkim subjekteve duke i mohuar kështu të drejtën të parkojnë në këto akse qytetarëve të tjerë.

Z.Pashuku shprehet se para pak kohësh ka kërkuar që Bashkia t'i drejtohet Autoritetit rrugor që rruga e fshatit në Nj.A. Bërdicë, të pajiset me ndriçim pasi aty ka katër kryqëzime që mund të bëhen burim aksidentesh.

Znj.Shkrela shprehet se vëren që ka mungesë transparence në lidhje koncertet dhe aktivitetet që zhvillohen në Shkodër duke kërkuar që qytetarët të informohen se ku shkojnë taksat e tyre. Ajo shton gjithashtu se do duhet që Z.Beci të kishte një reagim lidhur me autostradën e re që është bërë me pagesë, pasi mendon që ka një farë diskriminimi për veriun, ndërkohë që të gjitha autostradat e tjera janë pa pagesë. Ajo shton se nuk po ndiqet i njëjti standart.


Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka Z.Luli e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 28.6.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban ____faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Sabina DANAJ



KRYETAR

Oltion LUKA



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti

